

**Kushte më të mira pune dhe jetë me dinjitet!**

**Frangu i fuqizuar**

**Kundër largimi nga puna dhe shkurtimit të pagave**

**2**

**Alvaro Bizzarri**

**Me filma kundër padrejtësisë**

**3**

**Në shenjë nderimi!**

**Na la aktivisti i pathyeshëm Giovanni Giarrana**

**4**

Nr. 3 | maj 2015 | shqip

Botohet si shtojcë në gazetën «work» | Redaksia T +41 31 350 21 11, F +41 31 350 22 11 | info@unia.ch | www.unia.ch

**KKP, Demonstrata**

## Përpensionim të mëhershëm dhe një KKP më të mirë!



Më 27 qershor 2015 në Cyrih do të demonstrohet për pensionim të mëhershëm dhe një KKP më të mirë!

**Kontrata Kombëtare e Punës për ndërtimtarinë kryesore përfundon në fund të vitit. Pronarët e ndërtimit ka kohë që lënë të kuptojnë, se të arritura të caktuara si dhe pensionimi i mëhershëm të anulohen, gjegjësisht të përkeqësohen. Mirëpo puna në ndërtimtarinë mbetet e mundimshme dhe ka nevojë për kushte të mira dhe pensionim të mëhershëm. Andaj kërkohet që më 27 qershor t'ia mësyjmë Cyrihut për të luftuar për një KKP më të mirë!**

Kontrata Kombëtare Punës (LMV-CN-CNM) vlerësohet si njëra nga Kontratat më përparimtare të Punës. Ajo mundësoi që të hyjë në fuqi pensionimi i mëhershëm i punëtorëve të ndërtimtarisë. Ajo përcakton pos tjerash pagat minimale, parashihet shumë pushim vjetor se sa është ripararë dhe pagesë të mëtejme edhe në rast sëmundjeje. Mirëpo edhe kjo Kontratë si e tillë nuk është dhuratë e thjeshtë e punëdhënësve. Punëtorëve të ndërtimtarisë iu është dashur të

luftojnë për këto kondita të mira: e paharrueshme mbetet Demonstrata për pensionim të mëhershëm (FAR) apo edhe gjithë ato greva, të cilat janë zhvilluar përgjatë viteve kanë rritur presionin karshi punëdhënësve dhe treguan se, pa ne nuk bëhet asgjë!

**Punëtorët e ndërtimtarisë nën presion**

KKP është një Kontratë e mirë, mirëpo për të mbetur edhe më tej e mirë, ajo duhet ti përshtatet aktualitetit. Edhe

realiteti në kantiere të ndërtimtarisë me kalimin e viteve ka ndryshuar. Sot nëpër kantiere punojnë gjithnjë e më pak punëtorë ndërtimtarie, të cilëve ju duhet gjithmonë më shpesh për më pak kohë të kryejnë edhe më shumë punë. Presioni i afateve kohore nëpër kantiere është enorm. Dhe e tërë kjo krijon zhvillime shqetësuese: numri i aksidenteve nëpër kantiere sa vjen e rritet!

**Të mbrojmë punëtorët e ndërtimtarisë!**

Aksidentet shtohen. Mirëpo pos kësaj punëtorëve të ndërtimtarisë iu duhet të punojnë edhe në mot të keq. Numri i aksidenteve rritet edhe për këtë shkak, pasi punëtorët edhe për arsye të presionit të afateve kohore iu duhet të punojnë në mot të keq me shi e borë. Andaj konditat e punës në mot të keq duhet gjithsesi të përmirësohen në KKP! Nevojiten vija të qarta, kur duhet ndërprerë puna në rast të motit të keq.

**Duart larg nga pensionimi fleksibël në moshë!**

E pabesueshme por e vërtetë: pronarët e ndërtimit kërkojnë, pensionimi i mëhershëm me 60 vjet nuk duhet të vlejë më tej, porse duhet të shtyhet! Ata duan të justifikohen se me shkuarjen në pensionim të mëhershëm të shumë punëtorëve të ndërtimtarisë ngarkohen konditat e pensionimit fleksibël në moshë të

shtyrë (FAR) dhe se duhet zgatur mosha e pensionimit! Ne duam zgjidhje reale, që mundësojnë pensionimin e dinjitetshëm të punëtorëve të ndërtimtarisë me 60 vjet – dhe jo që si invalid dhe të papunë të shkojnë në pensionimin e merituar.

**Të gjithë në Demonstratë!**

Andaj ne duhet më 27 qershor të japim përsëri shenja të fuqishme. Ne nuk do të lejojmë të na merret pensionimi i arritur me luftë sindikaliste! Ne duam kushte më të mira pune në një kohë, në të cilën duhet të punohet edhe më shumë dhe më shpejt! E jani të gjithë në Cyrih. Ne kërkojmë më shumë mbrojtje dhe duart larg nga pensionimi ynë i mëhershëm! Pasi nëse ne mbrojmë KKP-në mbrojmë edhe Kontratat tjera të Përgjithshme të Punës!

☞ Aurora Garcia

Grumbullimi bëhet tek Limmatquai/Central në Cyrih, nga ku ne nisim në ora 12.30 marshimin. Informohuni në regjioni Tuaj, kur bëhet grumbullimi për trenat dhe autobusët e juaj të posaçëm dhe lajmërohuni me kohë për pjesëmarrje!

**Më 27 qershor të gjithë në Cyrih në Demonstratën e ndërtimtarisë!**

**Editorial**



**Të luftojmë bashkërisht: Për një Kontratë më të mirë dhe pensionim me 60 vjet**

Këtë vite fjala është për punëtorët e ndërtimtarisë dhe për shumëçka: Kontrata Kombëtare e Punës për ndërtimtarinë kryesore vlen vetëm deri në fund të vitit. Pa këtë Kontratë nuk kemi paga minimale në ndërtimtarinë, s'kemi pagën e 13-të të garantuar dhe s'kemi siguri të vijimit të pagës në rast sëmundjeje. Ne kemi edhe probleme të ndryshme, të cilat duhet ti zgjidhim me këtë Kontratë.

Së pari, punëtorët e ndërtimtarisë kanë nevojë për më shumë mbrojtje në rast të motit të keq. Sikur përpara edhe më tej për çdo vit vazhdojnë aksidentet: çdo i pesti punëtor i ndërtimtarisë. Për shkak të presionit kohor kolegëve ju duhet të punojnë më tej edhe në shi e borë. Këtu nevojiten përmirësime. Së dyti, nevojiten masa ndikuese kundër dumpingut në paga. Kolegëve tanë ju duhet të rropaten për pak franga në orë. Kjo është përfaqë të zezë, pasi shtyp pagat e të gjithë punëtorëve të ndërtimtarisë. Këtë vit na duhet të mbrojmë pensionimin me 60 vjet. Në vitet e ardhshme shumë koleg tanë hynë në moshën e pensionimit. Një pjesë e pronarëve të ndërtimit duan ta shfrytëzojnë këtë si shkas për të rritur moshën e pensionimit. Parlamenti i punëtorëve të ndërtimtarisë të Unias ka thënë qartas: Kjo nuk vjen në shprehje! Punëtorët e ndërtimtarisë do të luftojnë për pensionimin me 60 vjet.

Punëtorëve të ndërtimtarisë këtë vit do t'ju duhet të luftojnë për Kontratën e tyre dhe moshën e pensionimit me 60 vjet – bashkë me sindikatën Unia. Nëse ne luftojmë bashkërisht, shëfat nuk kanë shanse. Pasi ata ua kanë punëtorëve të ndërtimtarisë, posaçërisht kolegëve nga vendet tjera, për të ndërtuar. Andaj: Të luftojmë – bashkë jemi më të fortë!

**Nico Lutz**

Drejtues i sektorit të ndërtimtarisë në sindikatën Unia



Aksionet protestuese të punëtorëve të ndërtimit

## News

## Personeli i huazuar: me KKP të ripërtërirë

Pas Organizatave të punëmarrësve më 6 maj edhe Shoqata e punëdhënësve Swisstaffing ka aprovuar KKP-në e re për personelin e huazuar. KKP e re vlen nga muaji prill 2016 për tri vite dhe parasheh një rritje të përshkallëzuar të pagave minimale si në Zvicrën gjermane ashtu edhe në atë franceze. Për të pakualifikuarit do të ketë rritje prej 400 frangave, ndërsa për të kualifikuarit rritje prej 250 frangave në muaj. Si kundër hap do të fleksibilizohet lehtësori i punës: Kufiri i kohës shtesë të punës ditore obligative ngritët nga 9 në 9.5 orë.

## Syngenta shlyen 116 vende pune

Syngenta-s i shkojnë punët për shkëlqyeshëm: Vitin e kaluar ka pasur një fitim prej 1.5 miliarda frangash dhe pagat e menaxherëve janë rritur për 60%. Mirëpo në Monthey duhet të humben 116 vende pune. Sindikata Unia ka kërkuar nga Syngenta të heq dorë nga reduktimet e vendeve të punës dhe në vend të kësaj të shqyrtojë seriozisht alternativat. Nëse ngulet këmbë në ristrukturim, Unia kërkon që në vend të largimit nga puna të mundësohet një punësim i mëtejshëm në zonat tjera operative të ndërmarrjes.

## Manifesti për përkujdesje më të mirë

Me rastin e ditës së përkujdesjes, më 12 maj, sindikata Unia ka publikuar një manifest për përkujdesje më të mirë të pleqve. Në vend të punës pandërprerë dhe optimizimit të kostos në përkujdesjen e pleqve do të duhej që mirëqenia e njerëzve të jetë në qendër të vëmendjes. Manifesti do të kalon në një proces të gjerë aprovimi. Të gjithë personat e interesuar janë të ftuar të thonë mendimin e tyre. Në vende të ndryshme të Zvicrës në ditën e përkujdesjes për pleq zhvillohen aksione shpërndarjeje për të motivuar personelin e përkujdesjes për pleq që të marrin pjesë.

## Vdiq André Daguet

Ish anëtar i drejtorisë qendrore të Unia-s si dhe ish këshilltari nacional i Zvicrës dhe sekretari gjeneral i Partisë Socialdemokrate André Daguet ka vdekur më 30 prill si pasojë e sëmundjes së rëndë të muskujve ALS. Në vitin 1996 ai ishte anëtarë i drejtorisë qendrore të sindikatës SMUV (Shoqata Zvicerane e Punëtorëve të metalit dhe orëve) dhe deri në vitin 2008 mbeti anëtar i drejtorisë qendrore të sindikatës Unia. Ai ishte pjesëmarrës vendimtar në fuzionimin e SMUV-it dhe GBI (Sindikates së ndërtimtarisë dhe industrisë) si dhe sindikatave tjera.

## Të punësuarit e moshuar

## Masa për të punësuarat/it e moshuar tani!

**Bashkimi i Sindikatave të Zvicrës (SGB/USS) në mes të muajit prill paraqiti një plan masash për të punësuarit/et e shtyrë në moshë. Një javë më pas erdhi përgjigja nga kantonet, federata dhe partnerët social. Masat e propozuara nga federata janë të mirëpritura nga SGB/USS, mirëpo vlerësohen si të pamjaftueshme.**

Papunësia tek të moshuarit nga 55 deri 64 vjet ka arritur nivelin më të lartë rekord të dyshimit. Problemet janë të njohura mjaftueshëm: Punëmarrësit e moshuar pushohen më shpesh nga puna dhe ata kanë vështirësi të gjejnë përsëri një vend tjetër pune. Më herët shumica mund të shmangte papunësinë përmes pensionimit të më hershëm dhe sigurimit të invaliditetit, sot kjo nuk është më e mundshme për shkak të vështirësive financiare të arkave të pensionit dhe rregullave restriktive të sigurimit të invaliditetit. Konsekuencat: ata që janë mbi moshën 55 vjeç shpesh mbesin të papunë dhe pasi përfundon koha e përfitimit nga arka e sigurimit të papunësisë përfundojnë tek varësia nga ndihma sociale.

## Kërkesat

Si mund të përmirësohet situata e punëmarrësve të moshuar? Bashkimi i Sindikatave të Zvicrës që nga mesi i prillit paraqiti planin e masave që duhet ndërmarrë. Në njërin anë kërkohej që edhe ata që janë mbi moshën 55 vjeç të kanë të drejtë të trajnohen dhe riaftësohen e kualifikohen me pagesë. Pikërisht tek papunësia duhet

të kenë mundësinë e rikualifikimit. Gjithashtu edhe mbrojtja e shëndetit për të punësuarit e moshuar duhet të përmirësohet, gjegjësisht kontrolle më të mira të rregullave të mbrojtjes së shëndetit si dhe përshtatja e vendit të punës në përputhje me moshën. Gjithashtu duhet zgjeruar kompensimi në rast të pagave të humbura.

## Mbrojtja

Një kërkesë tjetër e rëndësishme është edhe mbrojtja në rast të pushimit nga puna për ata që janë plus 50 vjeç, të cilët kohë të gjatë kanë punuar në ndërmarrje, shembulli bie ashtu siç është paraparë në KKP të «Basler Chemie». Me këtë rast vlen posaçërisht të zgjaten afatet e largimit nga puna. Pos tjerash është e nevojshme të vlen ndalimi i diskriminimit siç është propozuar nga OECD (Organizata për Bashkëpunim e Zhvillim Ekonomik), para së gjithash me rasti e kërkimit të vendit të punës, trajnimit, pozitës në firmë dhe tek pagat.

## Sigurimi social

Nëse është e pashmangshme papunësia, edhe me këtë rast vlen zbatim i disa masave. Kështu katër vite



Kërkohej përmirësim i situatës së punëmarrësve të moshuar

para pensionimit numri i ditëve që kompensohen nga arka e papunësisë të ngritët nga 120 në 260 ditë kompozuese. Pos kësaj duhet të mundësohet që punëmarrësit edhe më tej të sigurohen për pension tek arka e pensionit të ish-punëdhënësit. Pensionimet e mëhershme duhet të mundësohen edhe në sektorë tjerë ekonomik. Federata duhet të mbështet materialisht zgjidhjet për sektorë, ashtu siç është rasti me ndërtimtarë.

## Masat e para të pamjaftueshme

Federata, kantonet dhe partnerët social megjithatë kanë diskutuar problemet e punëmarrësve të shtyrë në moshë dhe kanë vendosur edhe masat e para. Kjo është pozitive.

Mjerisht rezultatet mbesin larg asaj që ka kërkuar SGB/USS. Mirëpo me këtë konferencë është nisur një proces. Tek masat e parapara SGB/USS përshëndet veçanërisht masat vijuese: Angazhimin e punëmarrësve që më rastin e publikimit e vendeve të lira të punë të mos bëjnë kufizime moshe, gatishmërinë problemet e përkujdesjes të pensionit të të moshuarve që kanë përfunduar marrjen e kompensimit nga sigurimi i papunësisë ti hulumtojnë më saktësisht dhe të përpunohen masat e duhura. Pos kësaj edhe masat e parapara në arsimim dhe trajnim bashkë me qendrën kontaktuese për punëmarrës të moshuar dhe të papunë janë hapa në drejtim të duhur.

Aurora Garcia

## Frangu i fuqizuar

## Të luftohet suksesshëm largimi nga puna dhe shkurtimi i pagave

**Frangu i fuqizuar tanimë ka shkaktuar edhe viktimat e para: vetëm në sektorin e industrisë së metalike asaj elektrike dhe të makinerisë (MEM) janë zhdukur rreth 2000 vende pune. Unia kërkon nga Banka Kombëtare të përcakton përsëri kursin minimal të ndërrimit valutor. Në ndërkohë kemi shembujt të cilët tregojnë se i a vlen të luftohet!**

Në të dy muajt e fundit na bie të dëgjojmë gjithnjë më shpesh: me arsyetimin për frangut e fuqizuar, ndërmarrjet pushojnë nga puna punonjës me shumë vite përvojë pune si dhe shkurtojnë pagat dhe fusin orë shtesë pune. Para së gjithash në industri nuk janë të rralla mbylljet e ndërmarrjeve apo zhvendosja e tyre jashtë vendit.

## Luftë dhe suksese në Gjenevë

Shkurtim pagash, pagan me Euro dhe zgjatje e orarit të punës janë ilegale. Kundër kësaj ia vlen të luftojë i tërë stafi i të punësuarve. Tamam këtë e kanë bërë kolegët e kolegët e firmës «Mecalp Technology» në Meyrin të Gjenevës. Firma donte të shkurtohte pagat për 10% dhe të zgjaste orarin e



Me greva kundër reduktimeve e përkeqësimeve!



punës. Pos kësaj firma largoi tre punëtorë aty për aty nga puna. Si reagim ndaj kësaj padrejtësie turni i parë hyri vendosmërisht në grevë. Një pjesë e madhe e punonjësve të ndërrimit të pasdites iu kanë bashkangjitur atyre. Kjo detyroi drejtorinë e ndërmarrjes të tërheq ndryshimet dhe do të bisedohet për pajtueshmëri.

## Posaçërisht e prekur është Tiçino

Veçanërisht shumë beteja të punëtorëve për shkak të frangut të fuqizuar janë duke u zhvilluar në Tiçino. Fabrika e çelikut «Ferriere Cattaneo» donte të shkurtohte pagat e të punësuarve, 7% për të punësuarit që vijnë përtej kufirit dhe 3% për të punësuarit nga vet kantoni Tiçino. Kur të punësuarit refuzuan shkurtimet dhe kyçën sindikatën

Unia dhe atë të OCST firma tërhoqi shkurtimet. Para kësaj kishte një konflikt pune tek prodhuesi i pjesëve metalike SMB SA. Me këtë rast firma zgjati orarin e punës pa asnjë lloj kompensimi, çka punëmarrësit refuzuan. Firma me këtë rast largoi menjëherë nga puna tre kolegë, ndër ta edhe kryetarin e komisionit të personelit (këshillit të punëtorëve), të cilët punonin që 15 vite në këtë ndërmarrje. Pas grevës së punonjësve, drejtoria tërhoqi planet reduktuese.

## Sfidohet edhe politika

Me rastin e një konflikti tjetër në Tiçino, tek prodhuesi i materialeve plastike «Extern SA», në shkurt ishin paraparë shkurtime drastike. Punëmarrësit hynë në grevë për një javë të tërë. Tek pas intervenimeve të qeveritares Sadis erdhi deri tek procesi i ndërmjetësimit.

Politika ka detyrime. Jo vetëm se ajo duhet kërkuar nga Banka Kombëtare e Zvicrës të përcaktojë kursin minimal të këmbimit, porse edhe ndërmarrjet e prekura dhe të cilat kanë hasur në vështirësi financiare të krijuara për shkak të frangut të fuqizuar, ti ndihmoi përmes një fondi mbështetës. Tanimë në Gjenevë dhe Waadt janë planifikuar, gjegjësisht janë krijuar fonde të tilla.

Aurora Garcia

Votimet federale

# Për më shumë drejtësi

Më 14 qershor na presin votimet në nivel federal. Do të votohet për dy iniciativa dhe dy ndryshime ligjore. Bashkimi i Sindikatave të Zvicrës (SGB/USS) rekomandon për të votuar tri nga to: PO për iniciativën e bursave, PO për tatimin në trashëgimi dhe PO për Ligjin Radioteleviziv (RTVG).

Ligji i ri i Radiotelevizionit (RTVG) do të zbris taksat aktuale nga 462.– në 400.– franga. Kjo, pasi tani të gjithë duhet të paguajnë për taksat «Billag». Falë teknologjisë së re tani secili ka edhe përmes smartfonëve qasje në radio dhe televizion. Dhe falë taksave në kemi një ofertë të shumëllojshme dhe shumë gjuhësorë. Pikërisht në Zvicër, me gjuhët e shumta të saj, kjo është një komponentë e rëndësishme e shërbimeve publike.

**Arsimim për të gjithë!**

Iniciativa për bursa dëshiron tu mundësoi më shumë njerëzve arsimimin e tyre. Bursat duhet harmonizuar në nivel nacional – tani për tani secili Kanton vendos shumë ndryshe nga njëri tjetri se sa kujt i jep – dhe do të duhej të mundësohej për të gjithë, jo vetëm për Universitetet, por edhe për shkollat e larta profesionale të merren bursat. Andaj PO!

**Edhe të pasurit duhet të paguajnë!**

2% të tatimpaguesve posedojnë pasuri sa të gjithë tjerët që janë 98%. Dhe pasi pasurinë e tyre të madhe në Zvicër mund t'ua lënë në trashëgimi pasardhësve të tyre të liruar



Një hap i vogël për më shumë drejtësi sociale!

nga taksat tatimore, koncentrimi i pasurisë është duke u rritur pandërprerë. Kush trashëgon më shumë se 2 milion franga, duhet ti jep 20% mbrapa për të përgjithshmen (2/3 në

shtyllën e parë të sigurimeve sociale AHV/AVS, ndërsa 1/3 në Kantone). Është një hap i vogël për më shumë drejtësi sociale.

➔ Aurora García

TISA, liberalizimi i shërbimeve publike

# TISA: Jo privatizimit të shërbimeve tona

TISA (Trade in Services Agreement) është një marrëveshje tregtare, e cila ka për qëllim të hapë për tregun global për të gjitha shërbimet. Ka kohë që pas dyerve të mbyllura janë duke negociuar mbi 20 shtete – ndër to edhe Zvicra, mbi këtë marrëveshje, e cila do tu shërbente vetëm interesave të korporatave globale. Mirëpo kundërshtitë në Zvicër janë evidente dhe duhet të rriten edhe më shumë!

Qysh të negociohet fshehurazi? Po, shtetet të cilat janë të përfshira në zhvillimin e bisedimeve, nuk dhënë asnjë informatë në publikë: Edhe WTO (Organizata Tregtare Ndërkombëtare) është lënë jashtë

bisedimeve. Qëllimi është si duket të lihen anash shtetet e varfra të cilat janë kundër marrëveshjes. Të gjitha shtetet duhet faktikisht të marrin përsipër rregullat e parapara në marrëveshje.



**Ujë jo më për të gjithë?**

Çka domethënë TISA? Një nga pikat më të rëndësishme është lista e shërbimeve, të cilat nuk janë të hapura për tregun. Problemi është, që diçka që nuk është në listë, detyrimisht i lihet hapur tregut. Një birim i ri energjie, të cilën ne sot nuk e njohim, do te privatizohet automatikisht. De falë «klauzolës Ratchet» kjo më pas nuk mund të shpallet e pavlefshme. Kështu mund të privatizohet qasja në ujë

dhe rrymë, pa pasur mundësi që më pastaj kjo të kthehet mbrapa. Edhe futjen e sigurimit shëndetësor publik TISA e bënë të pamundur!

**Nënshkruajeni peticionin!**

Në Zvicër është duke u rritur kundërshtia. Në shumë komuna janë dorëzuar iniciativa për të mundësuar deklarimin e zonave të lëna të lira për TISA. Sa më shumë kundërshti aq më shumë shanse të ngadhënjem mbi TISA-n. Nënshkruajeni edhe ju peticionin online në: <http://stop-tisa.ch>

➔ Aurora García

Intervistë



Alvaro Bizzari

## «Me filma kundër padrejtësisë»

Alvaro Bizzari në vitet e 70-ta dhe të 80-ta përmes filmimit ka portretizuar jetën e stinorëve (punëtorëve sezonienë). Horizonte e ka takuar atë në Biel, në kuadër të ekspozitës «Barakat, ksenofobia dhe fëmijët e fshehur – andaj në Zvicër nuk duhet të ketë më status stinorësh» me ç'rast u tregua edhe filmi i tij «Lo Stgionale».

**Alvaro Bizzari, si keni ardhur në Zvicër?**

Unë vij nga një vend në afërsi të Pistoia të Toskanës: Unë isha 18 vjeç, ne kishim probleme me një shitore familjare. Babai më tha: shih, unë kam një mik në Zvicër, i cili fiton mirë. Nëse ne shkojmë për disa muaj në Zvicër, do të mund të zgjidhnim problemet e shitores. Kështu unë erdha në Zurzach të Kantonit Aarau, u punësova në një fabrikë dhe u bëra saldues. Unë mësova gjermanisht, më vonë edhe frëngjisht! Unë doja të komunikoj me njerëzit, pasi kuptova se ne të huajt trajtoheshim ndryshe nga zvicëranët.

**Çka ishte ndryshe?**

Ne kishim paga tjera, kushte tjera jetese, bile dhe në pjesën «latine» të Zvicrës! Ishin barakat, dëbimet e fëmijëve, të cilët nuk kishin të drejtë të banonin tek prindërit. Kjo me dukej e neveritshme. Unë doja të bëhesha kameramanë dhe të xhiroja një film mbi kushtet jetësore të punëtorëve të huaj, të cilin pastaj atë t'ua tregoja të gjithëve.

**Ku mësuat të bëni filma?**

Duke bërë filma. Unë fillimisht nuk dija të përdorja një aparat fotografik. Mirëpo unë shkoja në një dyqan fotografish, që quhej Foto Kühni, për çdo ditë dhe shikoja aparatet. Më pas u bëra shitës në atë dyqan – ngase dija gjermanisht, frëngjisht, italisht dhe kisha përvojë në shitje. Isha i ri dhe i gatshëm të mësoja të përdorimin e aparateve. Kur pronari i dyqanit pa pasionin tim për aparatet, më huazonte për çdo fundjavë një kamerë, për të ushtruar filmimin. Me këtë kamerë, në fundjave, xhirova filmin tim të parë «Il treno del Sud».

**Mirëpo ti e dije, se çdo të filmoje?**

Teknikën e filmimit e mësova duke lexuar me vëmendje dhe shumë kujdes udhëzuesin e aparatit si dhe ndoqa një kurs. Mirëpo teknika është një çështje, bërja e një filmi një çështje tjetër, gjë që ndodhi gjatë vrotimit. Në «Il treno del Sud» tregoja mbi shpresat e punëtorëve, të cilët kryenin punë të rrezikshme. Ishin punëtorët e huaj ata që ishin gjithmonë të diskriminuar.

**Si zhvilloheshin historitë?**

Unë njihja shumë njerëz, nga të cilët kam mësuar shumë histori jetësore. Në Pistoia kisha njohur papunësinë, varfërinë dhe luftën e punëtorëve. Atje unë zhvillova ndjenjën se çka është padrejtësia. Andaj për mua ishte e rëndësishme të tregoja se si ishte jeta e punëtorëve stinorë. Historitë i shkruaja unë, ndërsa artistët ishin të gjithë amatorë, njerëzit nga ky mjedis. Idetë janë marrë drejtpërdrejtë nga realiteti jetësor. «Lo Stgionale» ka të bëjë me fëmijët e fshehur të stinorëve – fëmijë, të cilët nuk guxonin të ishin në Zvicër. Filmi tregon se si ishte: gati për çdo ditë dëboheshin fëmijët nga Zvicra. Mua mu desh të filmoja edhe «Il Rovescio della Medaglia». Ky është një film dokumentar, ku shihen kushtet e mjerueshme në barka.

**Dhe si ishin reagimet në filmat tuaj?**

«Lo Stgionale» është treguar në shumë festivale filmash, ndër të tjera edhe në atë të Solothurnit. Shumë njerëz ishin të befasuar, ata nuk njihnin diçka të tillë, mendonin se barakat ishin depo materialesh, jo vende ku jetonin njerëz. Kur u tregua në televizion filmi «Il Rovescio della Medaglia» punëdhënësit provuan të pengojnë shfaqjen e tij. Më pas kanë provuar të më bëjnë presion për të bërë ndryshime të caktuara në film. Mirëpo unë nuk kam pranuar!

**Dhe tani a xhironi filma mbi refugjatët, të cilët vijnë në Evropë?**

Të gjithë e dijme se çka aktualisht ndodh në detin Mesdhe – panda dhe para kamerave të xhirimit. Atëkohë jo, njerëzit nuk dinin asgjë në lidhje me kushtet në të cilat jetonin e punonin punëtorët e huaj. Cili mund të ishte kontributi im tani? Gjithçka dihet, ndërsa zgjidhja e problemit është mjaft komplekse. Për të bërë diçka nevojitet bashkësia ndërkombëtare.

➔ Marília Mendes

Konferenca për migracion e sindikatës Unia të Zvicrës

# Faruk Osmani u zgjodh në Kryesinë Qendrore të Unia-s

**Të shtunën, më 16 maj 2015 u mbajt Konferenca vjetore e migrantëve në kuadër të sindikatës Unia. Si organi më i lartë i organizimit demokratik të migrantëve në sindikatë, Konferenca trajton tema sindikaliste në përgjithësi dhe në veçanti edhe ato që ndërlidhen me politikën zvicerane të migracionit, si dhe zgjedh përfaqësuesit e vet në organet e strukturat vendimmarrëse të sindikatës Unia. Në këtë konferencë për herë të parë u zgjodh një shqiptar nga baza në organin më të lartë të sindikatës Unia, në Kryesinë Qendrore!**

Unia, jo vetëm se është sindikata më e madhe në Zvicër, mirëpo ajo është edhe Organizata më e madhe e migrantëve në Zvicër. Të gjithë anëtarët e Unia-s pa pasaportë zvicerane i takojnë grupit të interesit të migrantëve. Këta përbëjnë mbi 50% të anëtarësisë së përgjithshme, që aktualisht janë mbi 100000 persona.

## Puna e grupit të interesit të migrantëve është e shumanshme

Migrantët Unia-s janë të organizuar në grupet e tyre te interesit nëpër seksione dhe regjione në tërë Zvicrën dhe posedojnë edhe me organet e strukturat e tyre, siç janë Konferenca dhe Komisionet e migracionit.



Faruk Osmani, në mes të rreshtit në këmbë, me aktivistë sindikal shqiptar

Ata zgjedhin edhe përfaqësuesit në organet dhe strukturat tjera të sindikatës Unia. Gjithashtu ata kanë të drejtë të organizohen edhe në Grupe e tyre gjuhësore, te cilat edhe pse me status nuk janë organe e struktura zyrtare të sindikatës, megjithatë kanë të drejtë të zgjedhin përfaqësuesit e tyre si nëpër sektorë, ashtu edhe nëpër organe e strukturat të sindikatës Unia, duke u nisur nga organet e strukturat drejtuese të seksionit e regjionit të tyre e deri në organet e strukturat nacionale të sindikatës.

Konferenca e migracionit zgjedh për katër vjet edhe 4 përfaqësuesit e vet në Kryesinë Qendrore të sindikatës Unia, ndërsa kësaj radhe u bënë zgjedhjet e jashtëzakonshme për deri në fund të vitit 2016. Në Kryesinë Qendrore u zgjodhën nga stafi profesional për migracion Aurora Garcia, ndërsa nga baza – aktivistet/ët sindikalist Ermelinda Reis Osório, Sidónio Candeias dhe Faruk Osmani.

## Model i organizimit të komuniteteve të migrantëve edhe më gjerë

Grupi i interesit të migracionit në Unia angazhohet për barazi shansesh, të drejtën dhe sigurinë e qëndrimit si dhe pjesëmarrjen e anëtarëve të saj pa pasaportë zvicerane në rrafshin politik në botën e punës dhe në shoqëri. Grupi i interesit të migracionit përpilon edhe një program vjetor, i cili praqet zgjidhjen e problemeve specifike të migrantëve. Unia u ofron anëtarëve të saj kurse gjuhësore si dhe trajnime e aftësime të ndryshme, të cilat u përshtaten në mënyrë specifike nevojave të tyre. Përmes gazetës «Horizonte» ky grup interesi i informon anëtarët e vet në 5 gjuhë migrantësh, ndër të cilat edhe në shqip. Shembulli i organizimit të migrantëve në sindikatën Unia ka shërbyer edhe si model për organizimin e strukturës së veçantë të migrantëve në kuadër të Partisë Socialdemokrate të Zvicrës në vitin 2012.

Osman Osmani, sekretar sindikal për migracion të Evropës juglindore

## U nda nga ne aktivisti i mirënjohur sindikalist Giovanni Giarrana

# Në shenjë nderimi!

**Kolegu dhe shoku ynë, aktivisti shumëvjeçar i sindikatës Unia, i mirënjohuri Giovanni Giarrana, vdiq të shtunën e kaluar më 16 maj 2015 pas një sëmundjeje të rëndë.**

**Përkundër sëmundjes së rëndë, Giovanni edhe në javët dhe muajt e fundit, u angazhua në aktivitetet dhe aksionet e ndryshme sindikatës, si në demonstratën e 7 marsit 2015, në aksionin e dorëzimit të peticionit të Kogresit të migrantëve të Zvicrës kundër dëbimit nga Zvicra, apo edhe në Forumin social botëror në Tunis.**

**Giovanni, do të na mungoi! Ngushllime për familjarët dhe për të gjithë të prekurit tjerë!**

Në vitin që lam pas 70 vjeçari Giovanni Giarrana as që i shkonte mendja tek vdekja. Motoja e tij ishte: «Më me dëshirë vdekja në front se sa në shtrat.» Ai dukej jashtëzakonisht në formë dhe plotë gjallëri. E kuqe e ndritshme, sikur këmisha e tij, është edhe bindja e tij. Edhe i ati ishte socialist, ndërsa Giovanni ishte edhe më shumë. Fjalja e tij e dashur ishte «Tanimë duhet ndërmarrë diçka!».

Greven e tij të parë ai e kishte apsolvuar qysh në bankat shkollore në Sicili, siç tragonte Giarrana. Ndërsa në Zvicër, qysh në kohën e SMUV (Shoqata Zvicerane e Punëmarrësve të Metalit dhe Orëve), Giarrana ishte kryetar i Komisionit për migracion. Së fundi ishte edhe Bashkëkryetar i Komisionit të migracionit në Unia. Migracioni ishte tema e tij jetësore. Ai kishte kaluar vet sfidat e tij: qëndrimi refuzues në kufirin zviceran në Chiasso, poshtrimi gjatë kontrollit sanitar

kufitar, tetë vjet të tëra jete nëpër baraka, diskriminimi në vendin e punës dhe gjatë kërkimit të banesës. Mirëpo e tërë kjo vetëm se ia ka përforcuar bindjen: Kush dëshiron më mirë duhet të luftojë.

Giarrana asnjëherë nuk ka dëshiruar të bëhej funksionar, edhe pse do ta pranonte me të dy duart. «Vendi im është tek baza», ishte bindja e tij e vendosur. Pa personat e besuar (aktivistët sindikalistë) nëpër ndërmarrje, sindikata nuk është asgjë. Ajo jeton e ndërtuar nga poshtë – lartë dhe jo nga lartë – poshtë.

Shumë vite punoi tek Escher-Wyss. Fotot e tregojnë atë nën tribunat gjigante. Deri në momentin kur ai hapi gojën së tepërmi: U shkarkua nga anëtarë i komisionit punëtor të ndërmarrjes, pasi para turmës së mbledhur kishte kritikuar shefin e koncertit, i cili donte të reduktonte 200 vende pune. Pa arsye, ngulte këmbë Giarrana.

Një njeri si ai nuk dëshprohej asnjëherë. Pak më vonë gjen një punë tek Burkhard Compression në Oberwinterthur, ku punon deri në pesnionim, më 2009. Edhe si i pensionuar nuk ndalet, nisi një aksion spektakular: Ai marrshoi 2500 kilometra deri në vendlindjen e tij në Sicili. «Natyrisht një marsh proteste!» precizonte ai. Kundër luftës, për paqe dhe solidaritet. E shoqëronin kamerat televizive si në start ashtu edhe në momentin e arritjes në Ravanusa në Provincën e Agrigentos. Atje ai pa për herë të parë dritën e kësaj bote, në vitin 1944. Asgjë nuk mund ta frenonte. Së fundi u angazhua fuqishëm kundër kesenofobisë dhe mbylljes në Zvicër. Së fundi apenonte me këmbëngulësi për një grevë simbolike të të gjithë migrantëve në Zvicër. Ashtu sikur ishte greva e grave më 1991. Për të treguar: «E dashura Zvicër, pa ne nuk bënë më asgjë!»



Giovanni Giarrana, aktivist dhe i pathyeshëm

Marilia Mendes



## Falimentimi: Megjithatë si mund të marrë pagën time?

**Në tetë vitet e fundit kam punuar si drejtues punëtorësh kantieri në një ndërmarrje ndërtimi. Tanimë ndërmarrja ka falimentuar. Për dy muajt e fundit nuk kam marrë pagë. A do të mund të marr parat e mija?**

**Po.** Pasi punëmarrësit nuk janë të siguruar vetëm në rast papunësie, porse edhe në rast paaftësie të pagesës së punëdhënësit. Andaj ju keni mundësinë që të shtroni kërkesën në Arkën e të papunëve të Kantonit për «kompensim të paftësisë paguese». Kjo është e drejtë e juaj, edhe nëse firma e juaj tanimë nuk ka mundësi të paguaj. Dhe në të vërtetë për maksimalisht katër muajt e fundit para deklarimit të falimentimit aktualisht në lartësi të shumës 10500 franga në muaj. Kërkesën tuaj për të drejtën e kompensimit duhet ta bëni më së voni 60 ditë pas bërjes publike të falimentimit. Qendrat regjionale për ndërmjetësimin e punës (RAV) në vendbanimin e juaj mund të ju jep informata më tejme. Arka e papunësisë (ALK) do tua paguaj rrogat mbetura borxh dhe kërkesën e juaj për pagë ia llogarit entit gjegjës për falimentim. Kërkesa juaj për pagë i parashtrohet Arkës. Rreziku që kërkesa juaj nuk mund të bëhet e vlefshme tek entit për falimentim e bartë Arka e papunësisë (ALK). Ju në secilin rast do të merrni pagat e juaja të mbetura.

Markus Widmer, work, 1.4.2015

## Përmbartimi: Kush paguan hapjen e falimentimit?

**Unë punoj si kontabilist në një biznes hidraulikësh. Qe katër muaj nuk kam marrë pagë më. Për këtë arsye kam bërë padi në gjyq e punës, i cili më ka dhënë të drejtë. Ani jam interesuar tek entit i përmbartimit mbi procedurat e mëtejme. Mua më është thënë se mund të adresojë rastin firmës tek entit i përmbartimit. Nëse nuk i marr parat e mija, atëherë më duhet të kërkoj hapjen e falimentimit tek gjyqi përkatës. Pos kësaj jam informuar se për të bërë hapjen e falimentimit tek gjyqit kompetent mua më duhet të bëjë një parapagim prej rreth 2500 franga. Mirëpo unë nuk kam mundësi ta bëjë këtë. Si mund të arrijë megjithatë të marrë pagën time?**

Informata e entit të përmbartimit është e drejtë. Si i besuar i punëdhënësit tuaj duhet të barti vet koston e mundshme të hapjes së falimentimit. Mirëpo ju keni mundësinë të paraqitni kërkesën për të ashtuquajturën ndihmë ligjore pa pagesë. Kjo ndër të tjera domethënë se ju mund të liroheni nga parapagimi mbi koston e gjyqit. Para se të parashtroni kërkesën për procedurë falimentimi, duhet të merrni kontakt me gjyqin dhe të parashtroni një kërkesë të tillë. Nëse kjo lejohet atëherë ju duhet nuk duhet të bëni parapagimin e shumës së rreth 2500 frangave. Edhe ashtu vlen: Veproni shpejt! Ju nuk duhet të pritni gjatë me procedurën e falimentimit. Përndryshe rrezikoni të humbni të drejtën e juaj. Informata të mëtejme mund të gjeni në broshurën «Kompensimi i paftësisë paguese». Atë mund të shkarkoni në: [www.espace-emploi.ch/publikationen/broschueren/](http://www.espace-emploi.ch/publikationen/broschueren/).

Markus Widmer, work, 1.4.2015

Impressum: Beilage zu den Gewerkschaftszeitungen work, area, Événement syndical | Herausgeber work, Gewerkschaft Unia, Chefredaktion: Marie-José Kuhn; Événement syndical SA, Lausanne, Chefredaktion: Sylviane Herranz; Edizioni Sociali SA, Lugano, Chefredaktion: Claudio Carrer | Redaktionskommission A. Garcia, D. Filipovic, E. Sariastan, M. Martin, M. Mendes, O. Osmani | Sprachverantwortlich Osman Osmani | Layout C. Lonati, Unia | Druck NZZ Print, Zürcherstrasse 39, 8952 Schlieren | Adresse Unia Redaktion «Horizonte», Weltpoststrasse 20, 3000 Bern 15, osman.osmani@unia.ch



Die Gewerkschaft. Le Syndicat. Il Sindacato.

www.unia.ch